



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 90

Prishtinë, më 17.01.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Danush Ademi, Agim Ademaj, Armend Zemaj, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Doruntinë Maloku, Valdete Bajrami dhe Pal Lekaj.

Mungoi: Milena Miliçeviq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Dren Ajeti -GSJP, Driton Vitia -Kosova Sot; Rita Spahiu - Praktikante; Sanije Berisha -OSBE; Liridona Xhemajli- RTV21; Egzon Pacolli- Praktikant; Granit Berisha- Praktikant; Eugen Cakolli -KDI; Shefki Kastrati- NDI dhe Gresa Ramadani- Praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.11.2016;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2016;
4. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit nr.05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e sanksioneve penale;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.11.2016;

Kryesuesja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29.11.2016 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2016

Kryetarja tha se duhet të theksohet se për shkak të zhvillimeve politike opozita nuk ka qenë pjesë e komisioneve parlamentare për disa muaj, kjo është evidentuar edhe në pjesën tabelore të këtij raporti. Ajo më tej shtoi se dy nga problemet që në vazhdimësi përballemi janë: mbikëqyrja parlamentare, pra monitorimi i ligjeve, dhe raportimet në komision kur dihet se vetëm një herë është raportuar para Komisionit për Legjislacion, pra po hasim në probleme kur është koha e raportimit të ministrave para komisionit, theksoi deputetja Haxhiu.

Armend Zemaj dha disa propozime në mënyrë që ky raport të jetë më i kompletuar. Ai tha se ajo çka duhet të plotësohet në këtë raport është jo vetëm pjesëmarrja në mbledhje, por të pasqyrohet puna edhe në grupe punuese, se pjesë e raportit duhet të jetë edhe zgjedhja e drejtorit antikorrupsion, anëtarësimi i anëtarëve të komisionit në GOPAC, dhe të gjitha aktivitetet që ka realizuar Komisioni për Legjislacion, theksoi z. Zemaj.

Pal Lekaj tha se dihet se fushëveprimi i komisioneve është të monitorojnë ligje, në këtë drejtim jo vetëm Komisioni për Legjislacion, por edhe komisionet e tjera nuk janë në gjendje të kryejnë në plotësi punën e tyre. Është obligim i çdo ministri të raportojë para komisioneve përkatëse dhe në këtë drejtim nuk duhet të ketë hezitim asnjëherë kur dihet se Kuvendi është monitorues i Qeverisë. Edhe z. Lekaj kërkoi që në raport të specifikohet koha kur deputetët e opozitës i janë kthyer punës në komision në mënyrë që të mos krijohet huti për ata të cilët e lexojnë këtë raport.

Selvije Halimi tha se duke marrë për bazë rrethanat në të cilat ka punuar Kuvendi dhe komisioni mendoj që ky raport i punës së komisionit është mjaft i kënaqshëm gjithmonë duke lënë hapësirë që të kërkojmë më shumë nga vetja që në të ardhmen të punojmë edhe më shumë në atë që obligohemi si komision, theksoi deputetja Selvije Halimi.

Agim Aliu tha se në këtë raport është paraqitur në mënyrë të saktë puna e jonë kur dihen edhe sfidat që ne kemi kaluar si komision. Por megjithatë komisioni ka pasur dhe ka rezultate pozitive, e sidomos është për t'u vlerësuar puna që është bërë në ligjet të cilat kanë kaluar për herë të parë, kur dihet se si vend kemi pritur gjatë që të kemi një ligj, siç është ligji për kundërvajtje, theksoi deputeti Agim Aliu.

Pas diskutimeve komisioni nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Të miratohet plani i punës së komisionit për vitin 2016 me ndryshimet e propozuara.

4. Shqyrtimi dhe miratimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetarja tha se sa i përket këtij projektligji janë disa çështje që duhet t'i kemi parasysh si komision për legjislacion në kohën kur amendamentohet ky projektligj. Ajo shprehu mospajtim me trajtimin shëndetësor për të burgosurit ku tha se përveç të drejtës për shërbime mjekësore të burgosurit duhet t'i nënshtrohen edhe kontrolleve rutinore dhe për shkak të disa çështjeve që i cekta më lart, në këtë fazë do të abstenoj, pra nuk do ta përkrah këtë projektligj, theksoi deputetja Haxhiu.

Agim Aliu tha se disa çështje në lidhje me këtë projektligj, me theks të veçantë neni i cili flet për shërbimin mjekësor për të burgosurit dhe për llogaritjen e viteve të burgimit ku shprehu habinë në atë se një të burgosuri i cili është i dënuar përjetësisht nuk mund t'i llogariten vitet e paraburgimit. Por megjithatë këto çështje do të parashtrihen edhe në seancë plenare, tha deputeti Agim Aliu.

Armend Zemaj tha se duke pasur parasysh se ligji aktual ka pasur disa zbrazëtira tani do të mundohemi t'i plotësojmë ato. Fokusi nuk duhet të jetë vetëm te të drejtat e të burgosurve, por edhe te të drejtave të punëtorëve të shërbimit korrektues, tha z. Zemaj. Në këtë fazë duhet t'i jepet përkrahje për arsyeje që në mes të dy leximeve të kemi mundësi të japim mendime apo edhe të plotësojmë të metat që ka ky projektligj, theksoi deputeti Armend Zemaj.

Selvije Halimi tha se edhe pse ky projektligj ka lëshime megjithatë është më i avancuar, dhe si komision duhet të punohet që këto lëshime të përmirësohen. Me qëllimin që të bëhet harmonizimi i projektligjit me ligjet e BE-se duhet të rregullohet edhe çështja sa i përket llogaritjes së ditëve të paraburgimit për të dënuarit ku tha se do të merren përvojat më të mira të vendeve të BE-së. Shqetësim është edhe çështja e trajtimit mjekësor dhe disa çështje të tjera të cilat si komision do të trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme, theksoi deputetja Selvije Halimi.

Me dy abstenime dhe shtatë vota për, Komisioni miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e sanksioneve penale dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve penale.

5. Të ndryshme

Deputeti Agim Ademaj, si kryesues i Grupit Punues për Projektligjin për Procedurën Përmbartimore propozoi që dëgjimi publik për Projektligjin për Procedurën Përmbartimore të mbahet më 1 shkurt 2017. Anëtarët e komisionit u dakorduan që 1 shkurti 2017 të jetë data kur do të mbahet dëgjimi publik.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu

